



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 134/<sub>//</sub> prot.

Tiranë më 13. 5.2020

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 13. 5.2020

PËR KONTROLLUESIN ANGELUS LEX SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Angelus Lex SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 35, datë 14.02.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit Angelus Lex SHPK, me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Hetimi administrativ, pranë kontrolluesit, u fokusua në:

- (i) trajtimin e ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një subjekt i të dhënave personale (prind i një debitori të institucionit financiar jo bankë IuteCredit Albania SHA), ku pretendohet se shoqëria Angelus Lex SHPK ka kryer përpunim të të dhënave personale në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”); dhe
- (ii) verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Angelus Lex SHPK gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Angelus Lex SHPK është një shoqëri e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, *“ofrimin e konsulencës ligjore, mbledhje detyrimesh, kredi bankare, ekzekutime vendimesh gjyqësore, etj.”*

Në kuadër të trajtimit të ankesës, nga hetimi administrativ i ushtruar rezulton se Angelus Lex SHPK është autorizuar nga shoqëria IuteCredit Albania SHA, në bazë të Marrëveshjes së Shërbimit *“Për mbledhjen e detyrimeve të pa-arkëtuara”*, datë 27.05.2019 (në vijim, *“Marrëveshja e Shërbimit”*), të lidhur midis këtyre dy subjekteve, për mbledhjen e detyrimeve të debitorëve ekzistues të institucionit financiar jo bankë IuteCredit Albania SHA, të cilët rezultojnë të kenë vonesa në pagesat e detyrimeve të tyre kontraktuale ndaj kësaj të fundit.

Institucioni financiar jo bankë IuteCredit Albania SHA, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, ka vendosur në dispozicion të përpunuesit Angelus Lex SHPK, ndër të tjera, të dhënat e debitorit z.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se përpunuesi Angelus Lex SHPK ka kontaktuar nëpërmjet telefonit prindin e debitorit, z. , në numrin e tij personal të telefonit. Ankuesi, z. , në ankimin e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, pretendon të jetë telefonuar nga zyra e përpunuesit Angelus Lex SHPK me qëllim për të marrë informacion në lidhje me debitorin z.

Përpunuesi Angelus Lex SHPK ka përpunuar të dhënave të subjektit të të dhënave (në këtë rast të ankuesit z. ), i cili nuk është subjekt i Marrëveshjes së Kredisë të nënshkruar nga debitori z. me kontrolluesin IuteCredit Albania SHA. Mungesa e pëlqimit të subjektit të të dhënave, në përputhje me parashikimin e pikës 24 të nenit 3 të Ligjit, përbën përpunim të dhënash personale në kundërshtim me parimet e nenit 5 dhe kriteret e nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit. Në këtë rast, ekzistenca e pëlqimit është e vetmja mundësi për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të ankuesit. Për sa kohë përpunimi i të dhënave të z.

nuk është parashikuar në marrëveshjen e kredisë të nënshkruar nga debitori z. me shoqërinë IuteCredit Albania ShA, kontaktimi i subjektit të të dhënave (prind i debitorit) është i paligjshëm duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në pikën 1 të nenit 5 të Ligjit.

Ky lloj përpunimi, pavarësisht mënyrës së sigurimit të të dhënave personale, të prindit të debitorit, nuk garanton zbatimin e detyrimit të parashikuar në gërmës “a” të pikës 1 të nenit 6 të ligjit. Të dhënat personale përpunohen vetëm: *a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin.*

2. Në pikën 10 të nenit 3 të Marrëveshjes së Shërbimit, është parashikuar që përpunuesi Angelus Lex SHPK duhet të kontaktojë vetëm klientin/debitorin e IuteCredit Albania SHA nëpërmjet të dhënave dhe kontakteve të marra prej kësaj të fundit. Në këtë rast, përpunuesi ka përpunuar të dhënat e ankuesit, z.

në kundërshtim me këtë parashikim kontraktual, duke vepruar gjithashtu në kundërshtim me parashikimin në germën “a” të pikës 1 të nenit 20 të Ligjit.

3. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Angelus Lex SHPK nuk kishte përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Në pikën 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet se njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë.

Angelus Lex SHPK, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e saj që prej datës 13.05.2015.

Në pikën 1, të nenit 25 të Ligjit parashikohet se kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

4. Nga verifikimi i kryer rezultoi se Angelus Lex SHPK nuk disponon “*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Kontrolluesi Angelus Lex SHPK bën pjesë në kategorinë e subjekteve përpunuese të mëdhenj në kuptim të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”). Vërehet mosplotësim i detyrimeve në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe

administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale, siç parashikohet në udhëzimin e sipërpërmendur.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Angelus Lex SHPK ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Angelus Lex SHPK, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimi nr. 48”), si dhe është një sistem i certifikueshëm për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 11.03.2020, u mbajt një seancë dëgjimore në praninë e përfaqësuesit të Angelus Lex SHPK.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se Angelus Lex SHPK ka marrë dhe po vijon të marrë masa në drejtim të rikuperimit të mangësive të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- Lidhur me përpunimin e të dhënave të ankuesit ka informuar se në zbatim të nenit 27 të ligjit, ka marrë masa duke shkatërruar të dhënat e tij.

Në lidhje me këtë çështje, rezulton se, më datë 10.03.2020, ankuesi z. \_\_\_\_\_ ka depozituar një kërkesë pranë Zyrës së Komisionerit, nëpërmjet së cilës ka tërhequr ankimin ndaj Angelus Lex SHPK.

- Lidhur me plotësimin e detyrimit për njoftim, aktualisht Angelus Lex SHPK e ka plotësuar këtë detyrim nëpërmjet plotësimit *online* të formularit të njoftimit në faqen e Zyrës së Komisionerit.
- Lidhur me “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, Angelus Lex SHPK është duke e hartuar në përputhje me parashikimin ligjor.
- Lidhur me ekzistencën e SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, Angelus Lex SHPK deklaroi se është në proces të krijimit të këtij sistemi në përputhje me Udhëzimet nr. 47 dhe 48.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton

përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 20, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, si dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Angelus Lex SH të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
2. Angelus Lex SHPK, në cilësinë e përpunuesit të të dhënave, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen me kontrolluesin, sipas parashikimit në nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
3. Kontrolluesi Angelus Lex SHPK, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e "*njoftimit*" në lidhje me përpunimin e të dhënave për të cilat është përgjegjës, në rast ndryshimi të gjendjes së përpunimit;
4. Kontrolluesi Angelus Lex SHPK, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, të hartojë rregulloren e brendshme në të cilën të parashikohen masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
5. Kontrolluesi Angelus Lex SHPK, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit për "*Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*"), lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit "*Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*", si dhe certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

Subjekti kontrollues, në zbatim të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit kopje të certifikatës së përputhshmërisë.

6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të përmbushet brenda 30 ditëve detyrimi i treguar në pikën 4, si dhe brenda 90 ditëve detyrimi i treguar në pikën 5.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data marrjes dijeni të këtij akti;

7. Në rast mos përmbushjeje, nga ana e Angelus Lex SHPK, të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Rrjedhimisht, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet përkatëse administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.5.2020

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

